

25 Nëntor 2013

Dita Botërore për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave

Termat “**dhunë ndaj grave**” dhe “**dhunë me bazë gjinore**” përdoren për t’u referuar një vargu abuzimesh ndaj grave që krijohen nga pabarazia gjinore dhe statusi i nënshtruar i grave në shoqëri në raport me burrat.

Në 1993, Deklarata e Vjenës dhe Programi për Veprim përkufizuan dhunën ndaj grave si “një akt i dhunës me bazë gjinore që rezulton në dëmtim fizik, seksual, psikologjik apo vuajtje të grave apo kërcënim për akte të tilla, një shtrëngim apo heqje e paarsyeshme e lirisë, të cilat ndodhin në jetën private dhe atë publike”.

Format e dhunës me bazë gjinore përfshijnë, por nuk janë vetëm: dhuna në familje, abuzimi seksual, përdhunimi, ngacmimi seksual, trafikimi i grave, prostitucioni i detyruar dhe praktika lënduese tradicionale.

Dhuna ndaj grave është një formë e përhapur e dhunimit të të drejtave të njeriut, e cila është llogaritur se mund të prekë, në një formë a në një tjetër, një në tre gra në mbarë botën.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë një nga format më të zakonshme të dhunës ndaj grave është ajo e ushtruar nga bashkëshorti ose partneri intim. Fakti që gratë janë shpesh të përfshira emocionalisht dhe të varura ekonomikisht ndaj atyre që i viktimizojnë ka ndikime të mëdha si në dinamikën e abuzimit dhe në përjasjet për ta trajtuar atë.

Në 48 studime të kryera në vende të ndryshme të botës, nga 10% deri në 69% e grave raportuan se janë dhunuar fizikisht nga një partner intim në një moment të jetës së tyre.

Sipas një studimi transversal të realizuar në Shqipëri në vitin 2003, rezultoi se më shumë se 1/3 e grave të martuara (37%) kishin eksperiencë të dhunës fizike gjatë vitit të fundit. Gratë me nivel të lartë edukimi dhe me karrierë profesionale rezultuan me risk më të lartë për t’u prekur nga dhuna. Shpjegimi për këtë fenomen lidhet me faktin se kjo kategori e grave e percepton më mirë dhunën dhe e raporton atë.

Studimi i OBSH i vitit 2012 mbi ‘Përvojat negative gjatë fëmijërisë të të rinjve Shqiptarë’ gjeti se rreth 30% e studentëve të intervistuar kishin qenë gjatë fëmijërisë dëshmitarë të dhunës së ushtruar ndaj nënës së tyre.

Hapa të rëndësishëm përpara në parandalimin e dhunës ndaj grave janë bërë me hartimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, si dhe me miratimin e Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i cila ka hyrë në fuqi në 1 qershor 2007.

Ndonëse fushatat sensibilizuese kundër dhunës ndaj grave janë intensifikuar vitet e fundit kudo në botë, gjithashtu edhe në Shqipëri, sërish dhunimi i grave mbetet një problem madhor global, por edhe për vendin tonë. Kjo ditë synon intensifikimin e përpjekjeve sensibilizuese ndaj kësaj problematike.